

POLITIKA E PRIVATËSISË - FAQJA E INTERNETIT

Kjo Politikë e Privatësisë ofrohet në përputhje me Nenin 13 të Ligjit 124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me përpunimin e të dhënave tuaja personale gjatë përdorimit të faqes zyrtare të internetit <https://www.eng.it/en/group/companies/engineering-albania> të Engineering Albania Shpk ("Faqa").

Ky dokument shpjegon qëllimet dhe metodat me të cilat përpunohen të dhënat tuaja personale, të dhënat personale që përpunohen, të drejtat që kanë subjektet e të dhënave dhe si mund të ushtrohen këto të drejta.

1. Kontrolluesi i të Dhënave dhe Nepunesi për Mbrojtjen e të Dhënave

Kontrolluesi i të dhënave tuaja personale, të përmendura në këtë Politikë të Privatësisë, është Engineering Albania Shpk me NIPT M324270091.

Kontrolluesi i të Dhënave ka emëruar një Nepunes për Mbrojtjen e të Dhënave (**DPO**), i cili mund të kontaktohet në adresën e mëposhtme të email-it: elona.mekshi@eng.it.

2. Kategoritë e të Dhënave Personale të Përpunuara

Kontrolluesi do të mbledhë dhe përpunojë të dhëna personale të një natyre të zakonshme përmes përdorimit të Faqes nga ana juaj.

Të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara mund të përfshijnë: Të dhënat e përdorimit të Faqes (klikime, historiku i kërkimeve, historiku i shfletimeve, të dhënat e përdorimit, të dhënat e shikimeve të videove, kohëzgjatja e seancës, ngjarjet e ndërveprimit, ngjarjet e faqes, informacioni i shfletuesit, informacioni i pajisjes, ndërveprimet e lëvizjes në faqe, adresa IP, numri i seancave, *shikimet e faqeve*, sistemet operative) dhe të dhënat e vendndodhjes (qyteti, provinca, rajoni gjeografik, gjuha, vendi).

3. Qëllimi i Përpunimit dhe Bazat Ligjore

Të dhënat tuaja personale mund të përpunohen për qëllimet e mëposhtme:

a) Analiza statistikore

Të dhënat tuaja mund të përpunohen nga Kontrolluesi me qëllim kryerjen e analizave dhe hartimin e statistikave mbi mënyrën e përdorimit të Faqes së internetit nga përdoruesit. Në bazë të **pëlqimit** tuaj (të menaxhuar përmes funksionalitetit përkatës në Faqe), Kontrolluesi i të Dhënave mund të analizojë në mënyrë të detajuar sjelljen tuaj të shfletimit (vizitat në Faqe, koha mesatare e kaluar në faqe, pajisja e përdorur, etj.)

b) Kryerja e kontrolleve të rrjetit, mbrojtja nga spam-i dhe bot-et

Të dhënat tuaja mund të përpunohen për filtrimin e Faqes së internetit nga trafiku, mesazhet dhe përmbajtja e padëshiruar (SPAM) ose për mbrojtjen ndaj aktiviteteve të botëve keqdashëse, për të kryer kontrolle sigurie mbi të dhënat dhe rrjetin, si dhe për të

parandaluar apo luftuar krimet e mundshme kibernetike. Këto përpunime realizohen në ndjekje të **interesit legjitim** të Kontrolluesit të të Dhënave për të garantuar sigurinë e sistemeve të tij të brendshme dhe për të zbatuar masa të përshtatshme mbrojtjeje.

c) Mbrojtja e një të drejte në gjykatë

Të dhënat tuaja mund të përpunohen gjithashtu me qëllim pohimin, ushtrimin ose mbrojtjen e një të drejte ligjore në gjykatë.

Dhënia e të dhënave tuaja personale për qëllimet e përcaktuara në pikën a) është opsionale. Ndërsa dhënia e të dhënave tuaja personale për qëllimet e përmendura në pikat b) dhe c) është e domosdoshme, dhe mosdhënia e tyre mund ta bëjë të pamundur për Kontrolluesin ofrimin e shërbimeve, plotësisht ose pjesërisht.

Kontrolluesi gjithashtu mund të mbledhë dhe përpunojë të dhënat tuaja personale përmes cookie-ve ose mjeteve të tjera të gjurmimit. Për më shumë informacion, ju lutemi konsultohuni me Politikën e Cookie-ve të Faqes.

4. Përpunuesit e të Dhënave dhe Personat e Autorizuar

Kontrolluesi i të Dhënave do t'i ndajë të dhënat tuaja personale me punonjësit dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët janë identifikuar dhe udhëzuar posaçërisht me akt të shkruar, në përputhje me ligjin 124/2024 ("Personat e Autorizuar"). Këta individë do t'i përpunojnë të dhënat nën autoritetin e Kontrolluesit të të Dhënave, vetëm për qëllimin e kryerjes së detyrave të tyre përkatëse të punës.

Të dhënat tuaja personale mund të ndahen gjithashtu me palë të treta, të cilat janë emëruar nga Kontrolluesi i të Dhënave si përpunues të të dhënave, në përputhje me Nenin 26 të ligjit 124/2024, ose, kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi, si kontrollues të pavarur të të dhënave.

Në veçanti, të dhënat tuaja personale mund të përpunohen për qëllime ndihmëse dhe/ose të lidhura me ofrimin e shërbimeve të ofruara nga palët e treta në kontekstin e shfletimit të Faqes.

Gjithashtu, theksohet se të dhënat tuaja mund të ndahen me autoritetet publike, nëse kjo kërkohet nga ligji ose me urdhër të autoriteteve kompetente.

5. Transferimi i të Dhënave

Në zbatim të qëllimeve të mësipërme, disa nga të dhënat tuaja personale mund të shperndahen me marrës të vendosur jashtë Bashkimit Evropian ose Zonës Ekonomike Evropiane (BE/EEA).

Në raste të tilla, Kontrolluesi i të Dhënave siguron që transferimi i të dhënave të realizohet në përputhje me dispozitat e Kapitullit IV të ligjit 124/2024.

6. Afatet e Ruajtjes së të Dhënave

Të dhënat tuaja personale do të ruhen duke respektuar plotësisht sigurinë dhe qëndrueshmërinë e

sistemeve të përdorura për përpunimin e tyre, për aq kohë sa është e nevojshme për të arritur qëllimet për të cilat janë mbledhur.

Në veçanti, ruajtja dhe përpunimi i të dhënave tuaja do të kryhet në përputhje të plotë me parimet e minimizimit të të dhënave dhe kufizimit të ruajtjes..

Përveç kësaj, Kontrolluesi mund të mbajë të dhënat tuaja personale për një periudhë më të gjatë, kur kjo është e nevojshme për të përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ligjore që e detyrojnë, ose për të kërkuar, ushtruar apo mbrojtur të drejtat e tij ligjore brenda apo jashtë gjykatës — gjithmonë brenda afateve maksimale të lejuara nga ligji në fuqi.

7. Të Drejtat e Subjekteve të të Dhënave

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, ju gëzoni të drejtat e mëposhtme:

- **Aksesi:** ju keni të drejtë të hyni në çdo kohë në të dhënat që lidhen me ju dhe që mbahen nga Kontrolluesi i të Dhënave, si dhe të merrni çdo informacion të dobishëm lidhur me përpunimin e tyre;
- **Korrigjimi:** ju keni të drejtë të kërkonit dhe të merrni korrigjimin dhe/ose përditësimin e çdo të dhëne të pasaktë që lidhet me ju dhe që mbahet nga Kontrolluesi;
- **Fshirja:** në rrethana të veçanta, ju keni të drejtë të kërkonit dhe të merrni, pa vonesë të panevojshme, fshirjen e të dhënave tuaja personale në posedim të Kontrolluesit;
- **Kufizimi:** në raste të caktuara, ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja;
- **Transportueshmëria:** në rast të përpunimit të automatizuar të të dhënave, të bazuar në pëlqimin tuaj ose në përmbushjen e një kontrate, ju keni të drejtë të merrni të dhënat tuaja personale në një format të strukturuar, të përdorur zakonisht dhe të lexueshëm nga makina, si dhe t'i transmetoni ato te një kontrollues tjetër pa pengesë;
- **Kundërshtimi:** ju keni të drejtë të kundërshtoni në çdo kohë, për arsye që lidhen me situatën tuaj të veçantë, përpunimin e të dhënave tuaja personale të bazuar në ndjekjen e interesave legjitime të Kontrolluesit, përveç rasteve kur ai provon ekzistencën e bazave ligjore bindëse që mbizotërojnë interesat, të drejtat dhe liritë tuaja;
- **Vendimmarrja e automatizuar:** ju keni të drejtë të mos i nënshtroheni një vendimi të bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar të të dhënave tuaja, përfshirë profilizimin, kur një vendim i tillë mund të ketë ndikim të rëndësishëm mbi ju.

Ju mund t'i ushtroni këto të drejta, në përputhje me Nenet 14-20 të ligjit 124/2024 duke kontaktuar Kontrolluesin e të Dhënave në adresën e përcaktuar në këtë njoftim ose duke shkruar te DPO-ja në adresën: elona.mekshi@eng.it

Pa cenuar asnjë mjet tjetër juridik administrativ ose gjyqësor, ju keni gjithashtu të drejtën të paraqisni një ankesë pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, nëse besoni se është shkelur ndonjë e drejtë që lidhet me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale.

Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://idp.al/> dhe <https://idp.al/kontakt/>